



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
01Nr 06-42508 /23
Klinë, dt 20,12 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 26.10.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi nënkryetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoi rendin e ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës;
3. Respektimi i të drejtave të njeriut, parandalimi i lypsarëve, me theks të veçantë i fëmijëve;
4. Të ndryshme.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: E shoh që në sallë disa nga anëtarët mungojnë, por, meqenëse jemi më shumë se gjysma, atëherë e shoh të arsyeshme që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar- ku besoj që të gjithë e keni marrë email-et e juaja dhe keni pasur kohë mjaftueshëm ta lexoni. Nëse jeni të gjithë dakord, ju lus të miratojmë me ngritje të dorës.

Falënderoj shumë, kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës ku bëjmë thirrje të përbashkët, toger, Besnik Qupeva në mungesë të komandantit sot, të cilin e falënderojmë shumë për prezencën e tij!

Pika 2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës.

Toger, Besnik Qupeva: Përshëndetje të gjithëve! Në mungesë të komandantit, unë, do të jem sot bashkë me ju në Këshillin për Siguri në Bashkësi.

Gjendja e sigurisë në Komunën e Klinës është stabile dhe e menaxhueshme. Unë do t'i paraqes disa statistika: Raste të iniciuara në total kanë qenë 60 raste, ndërsa vitin e kaluar kanë qenë 37, është një ngritje solide e rasteve, mirëpo natyrat e rasteve janë më të lehta se vitin e kaluar, vepra penale të iniciuara janë 34, që janë 8 vepra më shumë se vitin e kaluar, por, zbulueshmëria e tyre është në nivel më të lartë, nga 68% që kanë qenë të zbuluara vitin e kaluar këtë vit kemi rritje në 79.4% të zbulueshmërisë. Edhe raporti gjashtëmujor të cilin e kemi, zbulueshmëria ka arritur një rritje më të madhe fal angazhimit të palodhshëm të policëve tanë, aksidentet e trafikut janë të barabarta, nuk ka ndonjë rritje dhe persona të lënduar ka gjithmonë e më pak, kurse numri i tiketave sa i përket trafikut është shumë më i madh se vitin e kaluar për shkak se ka qenë një komunikacion shumë më i ngarkuar.

Kjo është në pika të shkurtra sa i përket statistikave dhe besoj që është mjaftueshëm për këtë pjesë, dhe nëse ka ndokush ndonjë pyetje, jemi këtu për t'u përgjigjur.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, shumë, toger! Ne e thamë që të gjithë këtu çka jemi, jemi të interesuar për sigurinë në komunën tonë e cila falë jush është në nivelin e duhur dhe falë bashkëpunimit të secilit qytetar bashkë me ju.

Unë desha të ndërlidhem me pyetjet e mbledhjes së kaluar, pyetje të cilat më shumë ndërlidhen me komunikacionin, shenjat e komunikacionit, tek sheshet ku janë theksuar, te sheshi "Ndue Përlleshi", te sheshi "Mujë Krasniqi" tek lagjja e "Sefermanëve". Pyetje me të drejtë të ardhura nga ju dhe ne e kemi ngrehë si çështje tek organet kompetente, besoj që bashkë me Policinë dhe drejtorinë përkatëse gradualisht kanë filluar të rregullohen, mirëpo, normal që edhe këto duan kohë. Nuk është që kam ndonjë përgjigje të saktë të them për këtë takim, se këtu kanë filluar me punime dhe këtu është rregulluar gjendja, por si temë e kemi diskutuar dhe besoj që bashkë me policinë dhe drejtorinë përkatëse do të rregullohen edhe këto që kanë mbetur.

Nëse nuk ka ndokush diçka, atëherë kisha kaluar në pikën e tretë të rendit të ditës. Po, Josip?

Z. Josip Dedaj: Faleminderit, nënkryetare, përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket fshatit Dresnik dhe Dolle, siguria realisht këta dy muaj ka qenë e qetë, pa asnjë problem, me përjashtim të problemit që e kemi me qentë endacakë që është problem në gjithë nivelin e Kosovës, por në fshatin Dresnik, sidomos fëmijët që ecin këmbë janë shumë të rrezikuar. E dimë se qysh kanë shkuar projektet e tenderimit të qenve por ende komuna më duket nuk ka bërë asnjë zgjidhje.

Sa i përket shenjave të komunikacionit, zonja nënkryetare, unë kam biseduar edhe nja dy herë në telefon me komandantin, kam dalë edhe me Luan Ahmetxheqaj dhe me dy jemi në komision, po ne s'na ka thirrur askush nga ana e komunës. Shenjat nuk janë të vendosura dhe është që një vit që është fituar tenderi për rregullimin e shenjave, disa vende ku gati s'ka pasur nevojë fare ndoshta janë vendosur, duke i përfshirë edhe fshatrat e komunës së Klinës që janë ballafaquar me

hekurudhën Pejë-Klinë nga ana e Budisalcit që nuk ka sinjalizim.

E treta: S' dua të flas për lagjen "Dedaj" në Dresnikë, t'u kisha lutur të vish një ditë me mua për të parë në çfarë gjendje është rruga. Tash po bëhet një vit që kemi pasur takim dhe këtu jemi ballafaquar me atë problem por ti na ke premtuar jashtë kryetarit, ti na ke premtuar në këtë sallë se edhe nëse s'ka buxhet ministria unë kam për tu përpjekur me buxhet të komunës me shtruar rrugën në atë lagje. Qe dy muaj nuk ka drita, ato drita e kemi fituar projektin përmes OSB-së, rrugën e re që e keni shtruar që shumica e qeverisjes tuaj komunale po lavdërohet që ka bërë rrugë për Dresnikë, që një muaj e gjysmë nuk ka drita, nuk ka trotuar dhe rruga është e ndërprerë dhe arsyen pse e dini ju, ku në fshatrat tjera i keni shtruar edhe oborret. Nëse doni edhe me emra ju them se janë hequr dyert, është shtruar rruga dhe janë vendosur dyert prapë, kjo është në përgjegjësinë e juaj. Në lagjen "Dedaj" ke qenë vet ndonjëherë edhe kur të doni unë ju dërgoj me parë gjendjen se çka është, 1km rrugë me 22 shtëpi, me 50 të rinjë/reja me fakultet dhe mos me qenë në gjendje me bërë këtë, mua është duke më ardhur turp të flas në çdo takim, ku nuk e di ju si e ndjeni veten, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, Josip!

Ti, fillimisht the që nuk dua të flas për rrugën, por fole prapë, megjithatë, unë të kam thënë prej fillimit që bashkëndjej kur të kam thënë për pjesën që do të mundohemi vetë, ajo nuk ka qenë premtim i imi personal sepse nuk janë fuqitë e mija që e bëjnë atë punë, por kam folur në emër të kryetarit i cili e ka synim që ta zgjidhë problemin dhe për të satën herë po e them që ju po ma merrni si shfajësim, se nuk është problemi te niveli komunal edhe ti e din që situata është e tillë. Kemi mbetur në situatë të palakmueshme, por juve si qytetarë fare pak ju intereson dhe duhet me ju interesuar se ku është problemi, sepse ju i doni të drejtat e juaja, të drejtat e pacenueshme që i duhen çdo qytetari. Unë për këtë bashkëndjej me ju dhe për pjesën tjetër e dimë shumë mirë ku ka ngecur situata, ndoshta këto kritikë tona nuk kemi mundur me i analizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, por jam shumë e sigurtë në atë që e them dhe ato që mua më thuhet.

Mund të jem edhe keq e informuar, por, unë mendoj kështu dhe kështu më është thënë, ku çalon problemi për rrugë kjo është. Sa i përket shtrimit të rrugëve, hiqet dera dhe shtrohet asfalti, edhe mundet me ndodhë, mirëpo nuk shtrohet rruga brenda dyerve prej komunës, por njerëzit participojnë ose e bëjnë vet atë pjesën materiale, kështu e di që ka ndodhur, kështu unë e besoj, përndryshe nuk ka të drejtë komuna të shtrojë në pronë private të askujt, as rrugën, as oborrin, as diçka tjetër. Unë po të tregoj e ti mundesh që mos ta besosh fjalën që e them, unë e them në atë çka unë e di, që nuk kemi të drejtë që në pronësi të dikujt private me shtruar rrugë, sepse kemi pasojë edhe gabimisht kur është shtruar është dashur me heqë, përndryshe kemi hasur në probleme, dhe mendoj që ata njerëz që e kanë bërë e kanë bërë me participim ose me pagesë personale.

Hekurudha nuk ka sinjalizim, unë e di punën që e bën dhe jam e sigurt që je më i informuar se ne tjerët, sepse i frekuenton të gjitha pjesët e rrugëve, si çështje duhet me u diskutuar dhe me u rregulluar. Unë e di që edhe ajo mbrojtësja që është vendosur brenda ditës është dëmtuar, e kam parë në media dhe ky është një problem që ndodh nga pakujdesia e qytetarëve, por, kjo ne nuk na justifikon që duhet me vendosur prapë.

Projekti i tenderimit të trajtimit të qenve endacakë e kemi diskutuar dhe drejtorja përkatëse e ka diskutuar që është tenderi, dhe e ka diskutuar shpeshherë që janë duke u trajtuar qentë endacakë

dhe gjithë ata qenë endacakë jo vetëm që trajtohen, por e kanë edhe një shenjë dalluese që janë të komunës sonë. Bile komunat i kishin edhe të ndara me ngjyrë, mirëpo, sipas rregullores nuk lejohet eliminimi i tyre apo të trajtohen me kohë të caktuar sipas tenderit, sipas atyre paramasave që dikush i ka vendosur, për këtë jam e sigurt që e kanë bërë punën e vet, mirëpo, ne, si zona komunale nuk është që kemi barriera që mos me i lejuar qentë endacakë të kalojnë nga një komunë në komunën tjetër dhe nga kjo thuhet se qentë endacakë prej një komune kalojnë në komunën tonë dhe e kemi më të vështirë pjesën e kontrollit. Është e rrezikshme dhe paraqet pasiguri, sidomos te fëmijët dhe te moshat e shtyera dhe normal që ne duhet të jemi të vetëdijshëm që të merren masa dhe duhet prapë të diskutohet me drejtorin e drejtorisë përkatëse që të merr masa, dhe nuk është që unë këto probleme nuk i trajtoj dhe nuk i përcjelli aty ku duhet, por, nuk është që mundemi gjithmonë aty për aty t'i zgjidhim problemet. Herën e fundit është kërkuar jo vetëm sinjalizimi, por edhe zebrat dhe shenjat në rrugë që të theksohen edhe kjo është punë që kërkon shumë koordinim dhe po besoj që do të ndodh shumë shpejt, jo vetëm në atë pjesë që është diskutuar, por edhe në qytet brenda, zebrat dhe vijat ndarëse kanë filluar të zbehen dhe të shlyhen dhe normal që paraqet rrezik. E di që shpeshherë përgjigjet e mija nuk janë ato që i pritni, por janë këto që unë mundem m'i dhanë.

Z. Josip Dedaj: Meqenëse e arsytëve rrugën, asfaltimi në rrugë private nuk ka të drejtë komuna vetëm një rrugë, dua që ta kesh ndërmend, në Videjë, në anën e djathtë, pronar serb, janë të hequra dyert, e kam në foto por mund të shkojmë edhe ta shohim.

E përmendëm te lagja "Dedaj" kjo lagje është e barabartë me të gjithë banorët e komunës së Klinës, janë tatimpagues njëjtë sikur me Jashanicë, si me Zllakuqan, si me Dobërdol, sikur me Ujmir, si me Gllarevë, me të gjithë fshatrat e komunës së Klinës. Thuaj ti që kjo lagje nuk është e diskriminuar prej banorëve tjerë edhe këtë mundem me ta pranuar, diskriminim keni bërë, znj. nënkryetare! Nuk është vënë në projekt nga Ministria e Infrastrukturës për ta vënë atë transit, ju e keni vënë, kryetari e ka vënë, edhe sot le të hyjë në projekt, unë e di se qysh shkon projekti për t'u bërë transiti, më së paku duhet dy vite për shpronësim të tokave, prej udhëkryqit të Dollcit ku e kemi planifikuar rrethin, dmth kjo i ka në vitin 2019 që ka hyrë në projekt, 65.000 euro janë ndarë për fshatin Dresnik, për rrugë, dmth ai projekt ka shkuar në tjetër fshat. Ti mund të arsyetohesh sa të duash, po kjo është gjendja faktike për lagjen "Dedaj", ti mund të arsyetohesh si të duash.

Unë e kam edhe një problem, unë kam folur edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike, besoj që këto ditë e kam edhe një takim me të. Qendra zejtare, rruga "Dëshmorët e Kombit" përballë shkollës fillore "Ismet Raci", komandanti ka qenë aty se e kam parë shpesh aty, në ora 08:00 nuk ke ku ta parkosh veturën, njerëzit aty edhe përllahen e shahen mes vete, ne tash lokalim që e kemi nuk kemi ku ta lejmë veturën. Nuk ka banorë në Klinë që nuk e di se në çfarë gjendje është ai parking, ne jemi tatimpagues, paguajmë për këtë vend, paguajmë për lokal, paguajmë tatim komunal dhe nuk kam ku t'i parkoj dy vetura të autoshkollës prej njerëzve që e parkojnë veturën në 08:00 e mëngjes deri në 16:00 pasdite të cilët janë edhe personat kryetarë të komunës. Unë disa ditë edhe inspektorëve ju kam thënë ta vendosin një shenjë sepse policia nuk mund të vijë dhe të gjobis, as ta heq ndonjë automjet prej aty, nëse nuk ka shenjë. Duhet ditur cilat janë për lokale afariste, cilat janë për parking privat, aty s'ka qenë parking privat, por dikush e ka hequr shenjën edhe po i vendosin veturat që sipas meje kanë të drejtë përderisa nuk ka shenjë të

komunikacionit, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, shumë, Josip!

Ky është Këshilli Komunal për Bashkësi dhe secila temë që trajtohet këtu, trajtohet tema që e rrezikon jetën e çdo qytetari të Komunës sonë. Unë e kuptoj shumë mirë shqetësimin tënd dhe mos prit përgjigje tjetër nga unë, pos shqetësimit të përbashkët, mirëpo këtu jemi për siguri në Komunën e Klinës dhe jo për parking personal që ti s'ke ku ta parkosh. Po më vjen shumë keq që s'ke, por, unë nënkryetare jam edhe po ndodh po duhet ta parkoj me pagesë, edhe unë e kam të ndarë një vend, po më vjen keq që unë e them haptas që unë s'kam parking personal dhe shpeshherë me pagesë e lë, unë apo ajo me të cilën udhëtoj. E kuptoj shqetësimin, por kjo nuk paraqet sigurinë në bashkësi, nuk paraqet rrezik, paraqet rrezik për mua edhe për ty, këto janë për debat me publikun, këto janë kërkesa për kryetarin e Komunës dhe drejtorisë përkatëse. Mirë, unë jam shumë e interesuar që në këtë takim të diskutohen tema që shkojnë në rrezik të qytetarëve që e stabilizojnë gjendjen në këtë situatë, kjo nuk e shmang atë që ti e the ose me zhvlehtësuar kërkesën tënde ose timen, se edhe unë jam si ti sa i përket parkingut, por duhet me i trajtuar sa të mundemi pjesën tjetër të situatës që po na rëndon të gjithëve, frikën, gjendjen e situatës në komunën tonë. U diskutua çështja e një rruge asfaltuese të një qytetari të kombësisë serbe, sigurisht që ai e ka shpronësuar pjesën e vet, ka qenë personale dhe ai nuk e ka shtruar rrugën pa e shpronësuar, jam e sigurt për këtë dhe pastaj normal që shtrohet rruga atij e tjetrit e tjetrit.

Nëse ndokujt i intereson diçka tjetër pos kësaj që unë e them, është shumë me lyp detaje dhe me përcjellë gjendjen deri në fund, unë e them gjithmonë atë që unë e besoj dhe atë që unë e di, nuk di diçka përtej saj dhe nuk besoj që duhet të ndodh diçka përtej saj dhe besueshmëria është sikur puna e bindjeve, që nuk edukohen lehtë, çdo njëri ka bindjet e veta për një situatë të caktuar.

Unë jam e bindur dhe bindem me argumente që dikush m'i ofron, ndoshta ato argumente mund të mos jenë të sakta, por unë jam e obliguar që qytetarëve t'ju dal përballë në bazë të argumenteve që dikush m'i ofron, dhe unë besoj që m'i ofrojnë të sakta, përndryshe unë dal keq para jush dhe më vjen keq nëse ndodh diçka e tillë. Dikush tjetër a ka diçka apo kalojmë tek pika e tretë?

Pika 2. Respektimi i të drejtave të njeriut, parandalimi i lypsarëve, me theks të veçantë i fëmijëve.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Ka të bëjë me të drejtat e njeriut e në veçanti parandalimi i lypsarëve, me theks të veçantë i fëmijëve, dhe ajo çka Josipi tha më herët është e drejtë e çdo personi të gëzojë të drejtat e veta të lëvizjes, të banimit, të shkollimit, të emancipimit etj., e cilat janë konventë e rregulluar ndërkombëtarisht ku çdo shtet duhet t'i respektojë. E drejtë elementare e çdo njeriu është të ketë kushte, banim, të ketë një jetë dinjitoze, por sigurisht që këto shkojnë në bazë të asaj sesa është i zhvilluar një shtet, një komunë, sa ka aftësi dhe mundësi që qytetarëve të vet t'jua ofrojë më të mirat. Këtë temë e kam nxjerrë nga plani i përgjithshëm dhe vitin e kaluar e kemi diskutuar po të njëjtën temë dhe ende vazhdojnë

problemet e tilla.

Unë s'është që i frekuentoj shumë lokalet, por edhe unë dal ndonjëherë për ndonjë drekë dhe shoh shumë se nëpër lokale në qytetin tonë ka lypsar të moshave të ndryshme. Është shqetësuese, është e padrejtë, disa organizata dhe disa të tjerë mendojnë që është në mënyrë të organizuar që atyre personave dikush jua shkelë të drejtën, dikush i shfrytëzon dhe duhet dikush në nivelin lokal, policia në komunën tonë, inspektorati që i bie barra në nivelin lokal, të kontrollojë, t'i identifikojë dhe t'i parandalojë, sepse asnjëherë nuk je i qetë në vendin ku ti qëndron.

Ti ushqehesh dhe vjen një person dhe kërkon lëmosh dhe mbetesh në një gjendje të palakmueshme, nëse i jep lëmosh a i mbetet atij, ose a është i shfrytëzuar nga dikush tjetër, dhe kjo paraqet një lloj shkelje. Pjesa tjetër me injoruar është pjesa më e keqe që na ndodhë në aspektin human dhe njerëzor, dhe ajo që unë kisha dashur ta ndajë me ju, në këtë rast me rajonin policor edhe do t'ia paraqes si kërkesë inspektoratit, që të kenë kujdes, rrugët lokale të kontrollohen më shpesh edhe pse realisht nuk është sikur viteve të kaluara që ka pasur një numër të madh, po më duket që ka më pak, por janë ende prezent. Pjesën tjetër që është shkelje e të drejtave të fëmijëve është se këta fëmijë duke qëndruar nëpër dyqane lypsar, këta nuk janë pjesë e arsimit, nuk janë pjesë e shkollës, këta fëmijë nuk janë aty ku duhet dhe këta fëmijë që duhet të gëzojnë të drejtat e veta pa dallim ngjyrës, racës, besimit të cilit e kanë këta fëmijë kanë të drejta të barabarta të jenë pjesë e shkollës e institucioneve të komunës tonë dhe më gjerë. Jam e sigurt që nga të gjithë anëtarët e këtij këshilli janë të cilët kanë një përvojë institucionale, kanë shkollim dhe e kuptojnë shumë mirë gjendjen për të cilën po flas dhe jam shumë e sigurt që e kuptojnë edhe rastin për të cilin duhet me u marrë, faleminderit shumë! Nëse ka dikush diçka, urdhëroni?

Z. Jeton Sokoli: Përshëndetje për të gjithë! Zonja nënkryetare të përgëzoj për temën që e ke ngrehur sepse besoj që është një temë shumë e ndjeshme dhe është mirë të diskutohet dhe shpresoj që kësaj radhe do të kemi ndonjë hap konkret që do të merret në këtë drejtim. Fëmijë lypsar ka goxha edhe në qytetin e Klinës, ndoshta mbikëqyrja edhe prej policisë dhe me u marr me rastet me shikuar nga zanafilla se nga vijnë, nga po iniciohen këto dalje. Ne kemi pasur raste ku kemi shkuar te familjet e fëmijëve që i kemi hasur në rrugë dhe i kemi parë dy gjëra: e para kushtet nuk i kanë pasur aq të këqija sa për me dal me lyp, edhe e dyta; e kemi rastin kur para derës na doli baba i atyre fëmijëve i cili e kishte shishen e birrës në dorë e foli me ne. Pra, ne e kuptuam që fëmijët ishin të detyruar prej tij të dilnin me lyp. Unë isha me një zyrtar të zyrës për Mirëqene Sociale dhe kemi bërë thirrje me ndaluar detyrimin e fëmijëve, përndryshe s'do të marrin social e gjëra të tjera. Ata shumica prej tyre nuk shkojnë as në shkollë dhe ndoshta duhet me i detyruar prindërit që mos t'i detyrojnë fëmijët, sepse ka raste se ata nuk shkojnë deri vonë në shtëpi, deri sa ata ta mbledhin atë shumën e caktuar e atëherë me shkuar në shtëpi edhe pse prindërit janë të dytë të aftë me punuar, po nuk dëshirojnë, dhe nën dy; e kam ngrehur edhe më herët si çështje, disa persona që nganjëherë dalin në qendër të qytetit edhe pyesin se a ke një sekondë kohë dhe ata tregojnë që duan të mbledhin të holla për një person ose kauzë të caktuar, gjithmori nuk ka mbiemër ose nëse ka janë shumë të organizuar dhe e kemi parë edhe në reportazhet e ndryshme hulmuese që ka dëshmitarë që këta persona janë mashtrues, janë duke manipuluar edhe unë besoj që nëse hasim njerëz të tillë në qytetin e Klinës, policia duhet të marrë masa dhe duhet të shkojë deri te zanafilla nga vijnë, sepse ndoshta ata persona paguhen dhe kanë rrogë, jetojnë nga ajo rrogë, por duhet me shkuar te personi që është duke i mbledhur

dhe duke i detyruar që të dalin, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, shumë, pastor! U ngre edhe një çështje që faktikisht e kemi diskutuar edhe më herët. Kjo temë fakt që është siguri për qytetarët, por kjo pjesa më e madhe i takon policisë së Kosovës dhe unë sipas pak informatave të mija personale që i kam, i takon edhe minoriteteve të organizuara të cilët janë zinxhir që është problem edhe me i identifikuar edhe vet policia dhe do të ishte mirë, vështirë është me i eliminuar dhe ne si qytetarë nuk është që e kemi arritur atë pjekurinë kur të shohim në rrugë me raportuar policinë, sepse edhe këtyre ju duhet informata, ne nuk kemi aq policë në komunën tonë sa me i pasur, sa në trafik, sa në rreth, sa ku ka lypsarë, sa ku ka që kërkojnë donacione të ndryshme, etj., problemi është te ne qytetarët se s'jemi të vetëdijesuar t'i raportojmë rastet kur ndodhin. Fjalën e ka, togeri, Besnik Qupeva!

Toger, Besnik Qupeva: Faleminderit për pyetjen! Pasi e përfshinë domenin tonë që një vit e sa që jam në Klinë fillimisht unë e mbaj mend se jetoj këtu, numri i lypsarëve ka qenë shumë i madh, por për një kohë goxha të gjatë jemi duke punuar me disa familje të cilat nivelin e arsimimit e kanë shumë të ulët, familje të cilat nuk funksionojnë si familje. Janë eliminuar disa nga lypsarët problematikë, janë dy familje që unë i kam identifikuar, është duke u punuar me to por është problematikë, nuk është e thjeshtë sepse nuk varet gjithçka nga policia e Kosovës. Ne kemi komunikim të mirë me gjendjen për punë sociale dhe gjithë akterët që e prekin këtë fushë, është problematikë, po është duke u punuar në atë drejtim, ka përmirësim. Ndoshta keni mundur ta vëreni që numri i lypsarëve kohën e fundit nuk është edhe aq i madh, veçanërisht ditën e premte Klina vërshohet nga lypsarët, në bazë të gjuhës mund të jenë nga Shqipëria por deri tash nuk kemi mundur të vërejmë se kush janë apo si vijnë, ditët e tjera janë më të qeta.

Ndërsa personat që ju ndalin dhe ju kërkojnë një minutë kohë, ata janë të shoqatave të ndryshme ku ato shoqata edhe ekzistojnë edhe problemi ekziston, por ndodh që ka edhe persona që dalin për xhepin e tyre, rasti i fundit që ka qenë në media që është arrestuar një person në Klinë. Ajo ka ndikuar pozitivisht besoj dhe nga ajo kohë kjo dukuri në Klinë është goxha e rrallë. Mund të them që Klina është një prej vendeve që mund të krenohet për nga numri i lypsarëve sepse e ka numrin më të vogël, faleminderit shumë për kohën!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, shumë, toger! Po, hoxhë, urdhëro?

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Përshëndetje për të gjithë, shumë temë e qëlluar që të jetë në rend të ditës, nënkryetare! Ju e thatë shumë mirë se, si në aspektin fetar, si në aspektin kombëtar, çdo njëri duhet të respektohet, të nderohet, pa marrë parasysh cilës etni apo religjion i takon ajo/ai. Te lypsarët e thatë edhe ju, që në të kaluarën kemi pasur raste shumë dhe togeri na njoftoj tash që zakonisht këto lypsarë të premte edhe Sokoli e përmendi që ka parë foto të tyre, shpesh edhe në xhami kanë ardhur këto në ceremoninë kryesore që e kemi të javës kanë ardhur me fotografi të ndryshme që kanë manipuluar me to. Mirëpo, çka vijnë si shoqata që dy persona i orientojmë te Bashkësia Islame dhe atje ju ofrojmë ndihmë, përndryshe, jo! Ne i kemi përcjellë këto raste dhe dikush po manipulon me këta fëmijë dhe zakonisht i lëshojnë te ETC-ja, vijnë me një kombi

dhe shpërndahen nëpër qytet dhe vijnë në xhami dhe janë prej viseve të ndryshme, shumë pak janë prej Klinës, po prej vendeve të tjera. Mendoj që me bashkëpunimin e të gjithëve duhet që këta t'i sensibilizojmë dhe t'i ofrojmë, t'i përkrahim. Unë e shoh që edhe disa fëmijë më nuk po merren me atë punë, falë angazhimit e bashkëpunimit nga ana e të gjithë neve që kemi biseduar e jemi marrë me ta. Temë shumë e qëlluar dhe duhet të japim kontribut të gjithë çka jemi anëtarë të këtij Këshilli.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, hoxhë! Sigurisht që sigurinë në komunë janë institucionet që e bëjnë, mirëpo kur flet për sigurinë në një shkollë që është e kujdesshme, një xhami, një kishë që është e frekuentuar nga qytetarët dhe kur është kujdesi nga këto tri institucione, jam shumë e sigurt që qyteti do të jetë i sigurt. Unë ju përgëzoj dhe kërkoj që pavarësisht situatave të jemi të kujdesshëm, sepse ju ndoshta edhe më mirë se secili institucion mund t'i dalloni dukuritë negative të njerëzve. Nëse s'ka dikush diçka, kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës.

Pika 4. Të ndryshme.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Urdhëro, hoxhë?

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Nëse nuk bëhet shumë, unë po flas në emër të të gjithë anëtarëve dhe kërkojmë mirëkuptimin tuaj: tek orari i mbledhjes që po mbahet në ora 16:00, nëse ka mëditje kishim vazhduar si gjithmonë ta mbajmë prej orës 16:00, por nëse janë anuluar mëditjet, shkojmë në orar të zakonshëm të mbledhjeve. Thash, kërkoj falje nëse bëhem i tepërt dhe kërkoj mirëkuptim, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë që e ke marrë përgjegjësinë të flasësh në emër të të gjithëve për diçka shumë të natyrshme, sepse çdo punë që bëhet jashtë orarit, çdo kund në botë paguhet! Unë asnjëherë nuk e kisha marrë kohën e juaj bashkë me timen nëse nuk e kisha pasur një siguri që paguheni. Kemi qenë pothuajse ndër komunat që jemi paguar, të gjithë na kanë pasur lakmi si komunë dhe absolut nuk e di se si u ndal, i ka dy muaj por sipas informacioneve janë në proces të rregullimit diçka me rregullore, që do të bëhet pagesa e çdo anëtari të këshillit, përveç disa anëtarëve që e kanë të ndaluar pagesën, ata e dinë cilët janë! Në momentin që në mënyrë zyrtare më thonë që nuk ka pagesë, unë do të bisedojë me ju për kohën dhe mënyrën se si do ta mbajmë.

Nuk kam diçka akoma konkrete, pos zyrtarët që kanë bërë kërkesë dhe unë do t'ju informoj për çdo informacion që do ta marr, faleminderit shumë, hoxhë!

Z. Josip Bojaj: Sa herë që ka bërë Josipi ankesë diçka, je arsytuar që asnjë vlerë edhe këtë çka e tha hoxha e kemi diskutuar shumë herë dhe gjithmonë ke thënë: po, po, po, edhe po del, jo! S'po di çfarë efekti po kanë këto takime kur ne bëjmë ankesa, po unë s'jam duke parë diçka që

është duke u përmirësuar, nëse ju jeni duke parë, na tregoni!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Josip, faleminderit që si zakonisht nuk kursehesh fare! Nën një: nuk varet nga unë pagesa, nën dy: ju nuk është që s'jeni paguar, e di që dy takimet e fundit nuk jeni paguar. Ne, që dy vite jemi bashkë dhe unë nuk jap llogari për kohën që unë s'kam qenë, unë të kam thënë që do të paguhesh edhe je paguar dhe s'është e drejtë të thuhet diçka çka nuk është, është tërheqë në nivel të Kosovës dhe nuk varet nga komuna jonë. Ti që je lodhur që 12 vite mundesh me marr zëvendësim. Unë edhe për dy vitet e radhës jam këtu, pa ty s'do të kishe lezet ky takim për pyetjet e vazhdueshme që i ke, përndryshe mund të zgjedhësh, zëvendësim kemi, edhe unë, edhe ti, faleminderit!

Z. Josip Dedaj: E ke shumë gabim, se unë s'jam lodhur që 12 vite duke punuar. Jam kryetar i Këshillit Lokal dhe jam duke punuar shumë, mund ta pyesni edhe zv. komandantin e policisë, se mbajmë shpesh takime me të, unë jam duke u përpjekur për të mirën e qytetarëve. Ju, ua keni kthyer shpinën atyre tatimpaguesve që rrogat e juaja jeni duke i marrë një pjesë prej atyre, unë as s'jam duke ju fyer, as s'jam duke ju bërë gjë, jam duke e kërkuar të drejtën e atyre banorëve. Në fshatin Dollc dhe Dresnik, ma trego një projekt së fundi që është kryer që 4 vite

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Josip, edhe njëherë po ta sqaroj shumë mirë: Unë jam zv. kryesuese e KKSB-së, unë nuk jam kryetare e komunës, nuk jam kryesuese e asamblesë komunale, unë pyetjen tënde e dërgoj në vendin e duhur, ata ma japin përgjigjen dhe kaq! Ju e dini se nënkryetarja i ka detyrat e deleguara dhe nuk është ekzekutiv që unë mund të bëjë diçka, përndryshe, nëse ti nuk e beson, prapë po e them, nëse do të zgjidhej problemi, do të isha gëzuar më shumë se ti!

Nënkryetarja mbylli takimin duke i përshëndetur të gjithë dhe duke i falënderuar për prezencë secilin.

Procesmbajtësja,

Orgeta Sylaaj


Zv. KRYESUESJA,
Marqe Tapushi-Selmanaj

